VENDIM
Nr. 327, datë 18.5.2022

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 457, DATË 3.7.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR PJESËMARRJE NË QENDRËN E TRAJNIMEVE NË FUSHËN E PRONËSISË INDUSTRIALE, SI DHE PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËRKATËSE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 193/d, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 457, datë 3.7.2019, të Këshillit Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Në titullin e vendimit dhe në pikën 1, pas fjalëve "..., si dhe përcaktimin e tarifave përkatëse ..." shtohen "... dhe masën e shpërblimit të lektorëve ...".

2. Pas pikës 18 shtohet pika 18/1, me këtë përmbajtje:

"18/1. Masa e shpërblimit të lektorëve, për të cilët lidhet kontratë ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe lektorëve, të jetë, si më poshtë vijon:

a) 500 lekë/orë 60-minutëshe trajnimi, për kontratat me lektorët, të cilët do të përmbushin kriteret e mëposhtme:

i. të zotërojnë një diplomë "Master i shkencave" apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;

ii. të zotërojnë kualifikimin e nevojshëm në përputhje me modulin apo kurrikulën për të cilën do të angazhohen si trajner, të vërtetuar me dëshmi, diploma, për eksperiencën profesionale;

iii. të kenë jo më pak se 5 (pesë) vjet përvojë pune në fushën e pronësisë industriale;

iv. të kenë aftësi të prezantimit dhe të transmetimit të saktë e të qartë të informacionit te pjesëmarrësit;

v. të mos kenë qenë të dënuar me vendim të formës së prerë;

vi. zotërimi i gjuhës angleze përbën përparësi.

b) 1000 lekë/orë 60-minutëshe trajnimi për kontratat me lektorët të cilët do të përmbushin këto kritere:

i. të zotërojnë një diplomë universitare;

ii. të zotërojnë kualifikimin e nevojshëm profesional në përputhje me modulin apo kurrikulën për të cilën do të jenë angazhuar si trajner, të vërtetuar me dëshmi, diploma, rekomandime apo vërtetime për eksperiencën profesionale;

iii. të kenë jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën përkatëse;

iv. të kenë aftësi të prezantimit dhe të transmetimit të saktë e të qartë të informacionit te pjesëmarrësit;

v. të mos kenë qenë të dënuar me vendim të formës së prerë;

vi. zotërimi i gjuhës angleze përbën përparësi.

c) 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë, në rastet e hartimit të kurrikulave apo të materialeve të trajnimit për më pak se 6 orë trajnimi 60-minutëshe;

ç) Në rastet e rishikimit të kurrikulave, pagesa të jetë deri në 50% të pagesës së përcaktuar sipas shkronjës "c".

d) Për trajnerët e dërguar në kuadër të një projekti apo marrëveshjeje teknike të lidhur nga DPPI-ja me organizata të huaja në fushën e PI apo zyra homologe, kushtet për pagesat e trajnerëve sipas kësaj pike përcaktohen në marrëveshjen dypalëshe me atë organizatë apo në kontratën e projektit.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama